

## AKT – THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ V.P.A.” sh.p.k.

Sot ne daten **06.11.2023** , ne ortaket themelues :

**Z. Raffaele Cono**, shtetas italian , i datelindjes **16.02.1957** , atesia **Bonaventura** , lindur ne **Torre Annunziata (NA)** , banues ne **Via Oplonti , N. 92 Torre Annunziata (NA)**, i pajisur me karte identiteti italiane me nr **CA27392QH** , leshuar me date **02.10.2023** , madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Z. Giuseppe Lamacchia** , shtetas italian , i datelindjes **26.09.1965** , atesia **Vitoantonio** , lindur ne **Barletta** , banues ne **Largo Cellini B 1 Barletta (BA)** , i pajisur me pashaporte italiane me nr **YA5116171** , leshuar me date **12.08.2014** , madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” , kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “ **V.P.A.**” sh.p.k.

#### NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “ **V.P.A.**” sh.p.k. dhe eshte person juridik shqiptar

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901, date 14.04.2008, si edhe te ligjit per QKR-en.

#### NENI 2 SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne **Lagjja nr.1, Rruga Taulantia , nr pasurie 26/110+1-1/1 zk 8512, Durres.**

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryej aktivitetet si me poshte :

Fason. Prodhimin, importin dhe eksportin e kepuceve dhe perberesve te tyre ose derivateve ne formen e produkteve te gatshem ose te produkteve gysme te gatshme per llogari te veta ose ne emer te paleve te treta, si ne nivel kombetar dhe nderkombetar.

Keshillimin lidhur me prodhimin, tregtimin, importin dhe eksportin e kepuceve dhe perberesve te tyre ose derivateve ne forme te produkteve te gatshme ose gysme te gatshme per llogari te veta ose ne emer te paleve te treta, si ne nivel kombetar ose nderkombetar. Importin dhe eksportin per llogari vetjake te linjave ose makinerive teknologjike te nevojshme per prodhimin e kepuceve dhe perberesve te tyre ose derivateve.

Transporti per llogari te veta te produkteve te kepuceve dhe komponenteve te tyre ose derivateve si ne nivel kombetar dhe nderkombetar. Shoqeria mund te kryejte te gjitha veprimet e nevojshme per zbatimin e objektit te shoqerise dhe midis te tjerash te kryejte veprime tregtare dhe industriale, financiare, hipotekore dhe pasurive te patundshme duke perfshire blerjen, shitjen dhe shkembimin e pasurive te patundshme te lujtshme, edhe te

*Cono Raffaele*  
*Giuseppe Lamacchia*

*LA MACCHIA GIUSEPPE*

regjistruara, pasurive te palujtshme dhe te drejtave pasurish te palujtshme, qiramarrje dhe me qiradhenie aktive dhe pasurive te lujtshme dhe te palujtshme me perjashtim e qirave aktive financiare. Te zbatohet cdo forme te financimit (si dhe leasing-ut pasiv) me institutet e kredive, bankave, shoqerive dhe privateve, duke dhene garancite e nevojshme reale dhe personale. Te japi garanci bankare, kambiale dhe garanci reale ne favor te shoqerive kontrolluese, te kontrolluara dhe te lidhura dhe te kontrolluara nga nje e vetme qofte edhe ne brendesi te te njejtij grup. Te marri pjese ne konsorciume ose grupime shoqerish dhe asociim te perkohshem shoqerish. Te marre pjesemarrje dhe fitime ne shoqeri e ndermarje sipas depozitave ligjore gjithnje ne funksion te qellimeve te shoqerise, por jo ne menyre ekskluzive. Shoqeria mund te perdore perfitimet fiskale, shoqerore dhe financiare te parashikuara sipas ligjeve ne fuqi me ndryshimet e tyre, shtyrjet dhe modifikimet, per aktivitetin ne objekt, si dhe nga cdo ligj tjeter lehtesues si dhe lehtesimet e parashikuara nga Komuniteti Europian

#### NENI 4 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise "V.P.A." sh.p.k. eshte 1.000 (njemije) leke

Ky kapital perbehet nga 2-dy kuota dhe zoterohet nga :

Z. Raffaele Cono qe zoteron 50 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 500 leke .

Z. Giuseppe Lamacchia qe zoteron 50 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 500 leke .

#### NENI 5 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

#### NENI 6 ORGANET E SHOQERISE

-Asambleja e pergjithshme

-Administratoret

#### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :


-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.


-Ndryshimin e Statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve

-Emerimin dhe shkarkimin e likujduesave dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likujduesin dhe ekspertin kontabel.

  
GIUSEPPE  
LAMACCHIA

  
Cono Raffaele

-Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga aministratoret, perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti

### ADMINISTRATORET

**Administratori i shoqerise do te jete Z. Giuseppe Lamacchia , shtetas italian , i datelindjes 26.09.1965 , atesia Vitoantonio , lindur ne Barletta , banues ne Largo Cellini B 1 Barletta (BA) , i pajisur me pashaporte italiane me nr AY5116171 , leshuar me date 12.08.2014 , i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte riprteritje.**

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga asambleja,me shumice te thjeshte te votave,me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

### NENI 7

#### SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE

Pjesa e fitimit qe i takon seicilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu , Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera,te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

### NENI 8

#### PRISHJA E SHOQERISE


Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.

b)me vendim te asamblese se pergjithshme

c)me hapjen e procedurave te falimentimit

  
LAMACCHIA  
GIUSEPPE

Cont Raffaele  
Cont Raffaele

c)ne se nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perpurhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 per” QKR”

d) me vendim te gjykates

dh)per arsye te tjera te parashikuara ne statut

## NENI 9 LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emerone nje likujdator,i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendim e posacem te Asamblese se Pergjithshme,te marre me shumice te kualifikuar,pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likujduesit duhet te ftojne kreditorin per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj.Shoqeria e publikon dy here kete njoftim,me nje interval prej 30 ditesh,ne faqen e saj te internetit,si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

## NENI 10 PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura,likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likujduesit nuk mund te kundershohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

## NENI 11 MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykates kompetente per zgjidhje.

## ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“ V.P.A.” sh.p.k.

Raffaele Cono

Cono Raffaele  
Cono Raffaele

Giuseppe Lamacchia

LAMACCHIA  
GIUSEPPE